

# Udhëzues për përdorimin e platformës “Njoftim i Administratës Tatimore për Zbatimin E MSHTD-SË”.

Hapi I → Tatimpaguesit do të logohen në sistemin online tatimor E-Tax

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE** **E-Tax Shqipëri**

**Mirëseerdhët**  
Nëse tashmë jeni i regjistruar në eFiling mund të hyni në sistem. Në të kundërt duhet të regjistroheni që të hyni në sistem.

**Regjistro**  
Jeni një individ privat dhe doni të dorëzoni Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave Për Individët?  
Ju lutemi, për një regjistrim të ri ose për hyrje për herë të parë në sistem [Regjistrohuni këtu](#)

Nëse nuk jeni nënshëtitas Shqiptar, duhet të drejtoheni në zyrën më të afërt tatimore për tu regjistruar!

**Hyr në sistem | E-Albania Login**

Emri i Përdoruesit:   
Fjalëkalimi:   
Gjuha:

E lexova dhe bie dakord me [termat dhe kushtet](#)

Hapi II → Te rubrika eFiling Im, zgjidhni çështjet e mia për të krijuar një çështje të re.

**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE**

Deklarata | Listëpagesat | Librat e Shitjeve dhe Blerjeve | Kontabilitet | **eFiling Im** | Menaxhimi i Aksesit | Rreth eFiling

**Mirëseerdhët në e-Filing**

Versionet e kërkuesve të internetit::

- Internet Explorer nga versioni 10
- Mozilla Firefox nga versioni 25
- Google Chrome nga versioni 30

**Kujdes:** Kur përdorni Internet Explorer-in sigurohuni që pamja e përshtatjes është fikur.

Dokumentat e Mia  
Njoftimet e Mia  
**Çështjet e Mia**  
Profili Im

Hapi III → Përcaktoni llojin e çështjes “Njoftim i Administratës Tatimore për Zbatimin e MSHTD-së”

The screenshot shows the 'E-Tax Shqipëri' portal interface. The main navigation bar includes 'Deklarata', 'Listëpagesat', 'Librat e Shitjeve dhe Blerjeve', 'Kontabilitet', 'eFiling Im', 'Menaxhimi i Aksesit', and 'Rreth eFiling'. The left sidebar shows 'Të Gjitha Çështjet' with sub-items: 'Të Padërguara (1)', 'Çështje në Proces', and 'Çështje të Mbyllura'. The main content area is titled 'Çështje të Padërguara' and contains a search filter for 'Lloji i Çështjes' set to '???' and buttons for 'Kërko' and 'Pastro Filtrat'. Below this is a table with columns: 'Numri i Çështjes', 'Data e krijimit', 'Data e Përditësimit', and 'Lloji i Çështjes'. A modal window titled 'Krijoni një Çështje të Re' is open, showing a dropdown for 'Lloji i Çështjes' with the following options: 'Certifikate, Certifikatë', 'GeneralQuestion, Pyetje e Përgjithshme', 'KërkesëLirimMasaShtrënguese, Kërkesë për lirim nga masat shtrënguese', 'KËRKESËRIMBURSIMITVSH, Kërkesë Rimbursimi TVSH', and 'ShmangiaTaksimiDyfishtë, Njoftim i administratës tatimore për zbatimin e MSHTD-së'. The 'Krijoni' button is visible at the bottom of the modal.

Hapi IV → Përcaktoni llojin e të ardhurës për të cilën po kryeni njoftimin e zbatimit të MSHTD-së”

The screenshot shows the 'E-Tax Shqipëri' portal interface. The main navigation bar is the same as in the previous screenshot. The left sidebar shows 'Çështje në Proces' with sub-items: 'Të Padërguara (1)', 'Çështje në Proces', and 'Çështje të Mbyllura'. The main content area is titled 'Rastet e Marrëveshjes për Taksimin e Dyfishtë'. It contains a form with the following fields: 'Numri i Çështjes' (E0001351810), 'NID/NEPT' (empty), 'Emri i Tatimpaguesit' (empty), 'Drejtoria Rajonale Tatimore' (18, [empty]), and 'Statusi i kërkesës' (empty). Below the form is a dropdown menu for 'Zgjidhni Llojin e Të Ardhurave të Marrëveshjes për Taksimin e Dyfishtë' set to '???' with the following options: 'BUSINESS, Të ardhura biznesore', 'CAPITALGAIN, Fitimet Kapitale', 'COPYRIGHTHONORARY, Të drejtat e pronësisë - Honoraret', 'DIPENDENTSERVICES, Shërbimet e varura', 'DIVIDEND, Divident', 'INDEPENDENTSERVICES, Shërbimet e pavarura', 'INTEREST, Interes', and 'OTHER, Tjetër'. Buttons for 'Kthehu Prapa' and 'Pasues' are visible at the bottom of the form area.

## Formulari i të ardhurave Honorare

**Rubrika e parë** → Detajet e Njoftimit dhe baza ligjore sipas MSHTD-së

Data fillestare e njoftimit → Data fillestare e njoftimit është data që tatimpaguesit do të dorëzojnë formularin.

Shteti → Përcaktoni shtetin për të cilën po zbatoni marrëveshjen e eliminimit të taksimit të dyfishtë.

Neni i MSHTD → Neni i të ardhurës për të cilin po bëni njoftimin referuar marrëveshjes së eliminimit të taksimit të dyfishtë me shtetin përkatës.

Norma tatimore → Norma tatimore e përcaktuar në marrëveshjen e eliminimit të taksimit të dyfishtë.

Detajet e Njoftimit		<a href="#">Collapse</a>
Data fillestare e njoftimit	<input type="text" value="12.11.2025"/>	
Lloji i të Ardhurës	<input type="text" value="COYRIGHTHONORARY, Te drejta e pronësisë - Hon"/>	
Baza ligjore e njoftimit për zbatimin e marrëveshjes		
Shteti *	<input style="border: 1px solid #ccc;" type="text" value="???"/>	
Neni i MSHTD *	<input style="border: 1px solid #ccc;" type="text" value="???"/>	
Trajtimi i Tatimit sipas MSHTD		
Norma Tatimore *	<input style="border: 1px solid #ccc;" type="text" value="???"/>	

**Rubrika II** → Informacion mbi paguesin e të ardhurave

Paguesi i të ardhurave është tatimpaguesi resident në Shqipëri që bën njoftimin, kjo rubrikë plotësohet automatikisht nga sistemi.

Nëse është i lidhur me përfituesin e të ardhurave është informacion që përcaktohet nga Tatimpaguesi.

Informacion mbi Paguesin e të ardhurave		<a href="#">Collapse</a>
Emri i Entitetit/PF	<input type="text" value=""/>	
Statusi Ligjor	<input type="text" value="SH.P.K"/>	
Përshkrimi i Aktivitetit	<input type="text" value="Impor"/>	
Numri i Identifikimit Tatimor (NEPT)	<input type="text" value="L317"/>	
Adresa e Plotë	<input type="text" value="Rruga Sami"/>	
Data e regjistrimit	<input type="text" value="14.05.2013"/>	
I lidhur me Përfituesin e Të Ardhurave?	<input type="radio"/> Po <input checked="" type="radio"/> Jo	

### Rubrika III → Informacion për përfituesin e të ardhurave

Përfituesi i të ardhurave është shoqëria jorezidente në Shqipëri. Ky informacion do të plotësohet nga tatimpaguesi sipas rubrikave.

Informacioni mbi Përfituesin e të ardhurave		<a href="#">Collapse</a>
Emri i Entitetit/PF *	<input type="text"/>	
Klasifikimi i përfituesit të të ardhurave në shtetin e rezidencës tatimore *	???	
Numri i Identifikimit Tatimor (NIPT) *	<input type="text"/>	
Adresa *	<input type="text"/>	
Data e Themelimit	<input type="text"/>	
Vendi ku është themeluar entiteti	<input type="text"/>	
Vendodhja e zyrës Qëndrore *	<input type="text"/>	
Përshkrimi i Aktivitetit *	<input type="text"/>	
Vendi nga ku Entiteti/PF menaxhohet dhe kontrollohet	<input type="text"/>	
Rezidenca Tatimore (shteti ku tatóhet si rezident)	???	
A ka përfaqësues tatimor në Shqipëri?	<input checked="" type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo NIPT i Entitetit <input type="text"/> Emri i entitetit <input type="text"/>	

Të dhënat për të ardhurën → Përcaktoni natyrën/llojin e të ardhurës që shoqëria jorezidente ka përfituar (Patentë, E dr. letrare e Autorit, E dr. artistike e autorit, E dr. shkencore e Autorit, Markë tregtare, Skice ose model, Plan, Proçes, Formulë sekrete, Filmata kimatografik dhe filmata, Transmetime Radio –Televizive, E dr. e përdorimit të informacioneve lidhur me eksperiencën industriale tregtare dhe shkencore.

Të dhëna mbi të ardhurën	
Natyra e kërkesës për të drejtat e pronësisë *	???

Nëse lloji i honorarit nuk është asnjë nga përcaktimet për tu përzgjedhur, zgjidhni opsionin “Tjetër” dhe shkruani shkurtimisht natyrën e honorarit të hapësira “Detaje të tjera”.

Të dhëna mbi të ardhurën	
Natyra e kërkesës për të drejtat e pronësisë *	OTHER, Tjetër Detaje të tjera <input type="text"/>

Informacion në lidhje me kontratën e lidhur mes palëve, ose dokumentit që vërteton marrëdhënien kontraktuale mes palëve, ku të përcaktoni datën e nënshkrimit të kontratës/ fillimit të marrëdhënieve kontraktuale dhe datën e përfundimit të kontratës apo marrëdhënieve kontraktuale. Nëse kontrata/marrëdhënia kontraktuale është paafat vendosni çekun te kutia përkatëse.

Nëse kontrata/marrëdhënia kontraktuale është me afat të përcaktuar por me të drejtë rinovimi, përcaktoni periudhën e rinovimit.

Kontrata		<a href="#">Collapse</a>
Data e Nënshkrimit të Kontratës *	<input type="text"/>	
Data e Përfundimit të Kontratës	<input type="text"/>	
Pa Afat	<input type="checkbox"/>	
Me të drejtë rinovimi	<input type="checkbox"/> Specifiko <input type="text"/>	

## Rubrika e të dhënave të faturave

Për secilën faturë objekt njoftimi janë të detyrueshme për tu plotësuar të dhënat e kërkuara.

Të dhënat e faturave *		<a href="#">Collapse</a>
<a href="#">Eksporto në Excel</a>   <a href="#">Ringarko</a>   Shfaq 10 të dhëna		
<b>Numri rendor</b>	<b>Numri i Faturës së Huaj</b>	<b>Data e Faturës së Huaj</b>
<b>NSLF E Autofaturës/Autongarkesës</b>	<b>Data e Autofaturës/Autongarkesës</b>	<b>Shuma e Faturës</b>
Nuk ka të dhëna të disponueshme në tabelë		
<div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <span>E para E Mëparshme Pasues E Fundit</span> <span>Duke u shfaqur nga 0 në 0 prej 0 të dhënash</span> </div>		
<input type="button" value="Shto"/>		

Shuma e të ardhurës \*

???

**Të dhënat e faturave \***

Numri rendor	Numri i Faturës së Huaj	Data e Faturës së Huaj
Nuk ka të dhëna të disponueshme në tabelë		
<div style="display: flex; justify-content: space-between;"> <span>E para E Mëparshme Pasues E Fundit</span> <span>Duke u shfaqur nga 0 në 0 prej 0 të dhënash</span> </div>		
<input type="button" value="Shto"/>		

**Të dhëna për tatimin e mbajtur në burim**

Është paguar tatimi i mbajtur në burim?

**Informacion për Agjentin e Varur**

A ka agjent të varur, dhe a ushtron zakonisht në Shqipëri, autoritetin për kontrata në emër të përfuturit të të ardhurave?

**Informacion për Nënkontraktorin**

Emri i regjistruar

Shto të dhënat e faturës

Numri i Faturës së Huaj *	<input type="text"/>
Data e Faturës së Huaj *	<input type="text" value="01.01.1yyy"/>
NSLF E Autofaturës/Autongarkesës *	<input type="text"/>
Data e Autofaturës/Autongarkesës *	<input type="text"/>
Shuma e Faturës *	<input type="text" value="0"/> <input style="width: 50px;" type="text" value="???"/>
Shuma e Paguar *	<input type="text"/> <input style="width: 50px;" type="text" value="???"/>
Mënyra e pagesës *	<input style="width: 50px;" type="text" value="???"/>
Data e pagesës *	<input type="text"/>

Nëse mënyra e pagesës së faturës është me kompesim, duhet të ngarkoni dokumentin që vërteton kompesimin, ku të ketë të përcaktuar të dhënat e faturës që kompesohet, shumën e kompesuar dhe datën e likuidimit përfundimtar të faturës. (Psh. Nëse fatura e lëshuar nga tatimpaguesi jorezident me nr.001 datë 01.01.2024 është kompesuar me faturën e lëshuar nga tatimpaguesi resident në Shqipëri me nr. 002 datë 02.02.2024, dokumenti i kompesimit duhet të ketë të dhëna për numrin, datën, vlerën, llojin e të ardhurës për të dy faturat që kompesojnë njëra tjetrën)

Mënyra e pagesës *	COMPENSATION, Me ▾	Mënyra e pagesës *	COMPENSATION, Me ▾
Data e pagesës *	???	Data e pagesës *	
Dokumenti i Kompensimit *	BANK, Me Banke COMPENSATION, Me Kompensim	Dokumenti i Kompensimit *	Zgjidhni skedar
<input type="button" value="Krijo"/>		<input type="button" value="Krijo"/>	

Tatimpaguesi nëse nuk ka mbajtur tatim në burim për honoraret e marra nga shoqëria jorezidente, klikon kutinë JO.

Të dhëna për tatimin e mbajtur në burim		<a href="#">Collapse</a>
Është paguar tatimi i mbajtur në burim?	<input type="radio"/> Po <input checked="" type="radio"/> Jo	

Tatimpaguesi nëse ka mbajtur tatim në burim për honoraret e marra nga shoqëria jorezidente duhet të japë informacionet në lidhje me shumën e paguar dhe datën e pagesës së TB.

Të dhëna për tatimin e mbajtur në burim		<a href="#">Collapse</a>
Është paguar tatimi i mbajtur në burim?	<input checked="" type="radio"/> Po <input type="radio"/> Jo	
Shuma e paguar e tatimit të mbajtur në burim	<input type="text"/> <input type="text"/>	
Data e pagesës së TB	<input type="text"/>	

Komente shtese → është një rubrikë ku tatimpaguesi shkurtimisht do të informojë Administratën tatimore me informacion shtesë në lidhje me njoftimin që po kryen.

Komente shtesë(Nëse ka)	<div style="border: 1px solid #ccc; height: 60px;"></div>
-------------------------	---

## Rubrika e Dokumentacionit të kërkuar

Referojuni udhëzimit nr.11 datë 23.07.2024 pika 3.1, për kushtet dhe kriteret e dokumentacionit të kërkuar.

- 1- Certifikata e rezidences tatimore të perfituesit të të ardhurave, për vitin/vitet që janë përfituar të ardhurat objekt njoftimi, pra viti/vitet kur janë lëshuar faturat nga shoqëria jorezidente.
- 2- Kontrata e lidhur mes paleve
  - a. Nëse kontrata është depozituar me parë përcaktoni nr. e çeshtjes së sistemit me të cilën është depozituar kontrata

- b. Nëse nuk ka kontratë depozitoni dokumentacion tjetër që vërteton marrëdhënien mes palëve.
- 3- Fotokopje të faturës/ave të lëshuara nga shoqëria jorezidente, ose dokumente të tjera mbi të cilat mbështetet transaksioni.
  - 4- Dokumentet bankare (SWIFT/Urdhërtransfertë e vulosur nga banka/ statement të llogarise ose cdo dokumentat tjeter bankar që vërteton pagesën e faturave ), ose në mungesë të dokumentave bankare, ngarkoni dokumentin/et që vërteton kompesimin, ku të ketë të përcaktuar të dhënat e faturës që kompesohet, shumën e kompesuar dhe datën e likujdimit përfundimtar të faturës.

Dokumentet e Kërkuara për Këtë Formë		<a href="#">Collapse</a>
1. Certifikata e rezidences tatimore të perfituesit të të ardhurave, për vitin/vitet që janë përfituar të ardhurat objekt njoftimi *	<input type="button" value="Zgjidhni skedar"/>	Asnje skedar i zgjedhur
2. Kontrata e lidhur mes paleve (Nese nuk ka kontrate depozitoni dokumentacion tjetër që verteton marrëdhënien mes palëve) Nëse kontrata është paraqitur më parë, specifikoni numrin e aplikimit nën të cilin u paraqit kontrata	<input type="text"/>	<input type="button" value="Zgjidhni skedar"/> Asnje skedar i zgjedhur
3. Fotokopje të faturës/ave të lëshuara nga shoqëria jorezidente, ose dokumente të tjera mbi të cilat mbështetet transaksioni *	<input type="button" value="Zgjidhni skedar"/>	Asnje skedar i zgjedhur
4. Dokumentet bankare (SWIFT/Urdhërtransfertë e vulosur nga banka/ statement të llogarise ose cdo dokumentat tjeter bankar që vërteton pagesën e faturave ) *	<input type="button" value="Zgjidhni skedar"/>	Asnje skedar i zgjedhur

Pasi të keni mbaruar me plotësimin e formularit tatimpaguesit kanë mundësi ta ruajnë si draft përpara se ta dorëzojnë, ose mund të bëjnë më përpara një vlerësim të tij për të parë nëse mungon ndonjë informacion/dokument ose jo.

Shqyrtimi i dokumentacionit të “Njoftimit të Administratës Tatimore për zbatimin e MSHTD-së” do të kryhet nga struktura që mbulon MSHTD-të, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

\*Kujdes, kur nga shqyrtimi i informacionit të dhënë në formularin e digjitalizuar dhe dokumentacionit bashkëngjitur, sipas pikës 3.1 të Udhëzimit nr. 11 datë 23.07.2024, i ndryshuar, rezulton se ai nuk është i plotë dhe i saktë, struktura përkatëse në DPT, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e ngarkimit të dokumentacionit në sistem, do t’i dërgojë tatimpaguesit rezident në Shqipëri njoftimin për plotësim/saktësim dokumentacioni, duke specifikuar dokumentacionin e munguar apo për t’u saktësuar.

Tatimpaguesi rezident në Shqipëri duhet të bëjë plotësimin/saktësimin e dokumentacionit brenda 60 ditëve kalendarike nga njoftimi i DPT-së. Nëse dokumentacioni plotësohet/saktësohet brenda afatit 60-ditor, struktura përkatëse në DPT, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e depozitimit të dokumentacionit plotësues apo të saktësuar, do të njoftojë tatimpaguesin dhe DRT-në përkatëse mbi rezultatin e shqyrtimit.

**Nëse brenda 60 ditëve kalendarike, nuk bëhet plotësimi/saktësimi i dokumentacionit, çështja në sistem do të mbyllet (statusi “Mbyllur”), tatimpaguesi duhet ta ringarkojë dokumentacionin për njoftimin e zbatimit të MSHTD-së edhe njëherë, dhe si datë fillestare e njoftimit do të konsiderohet data e ri-ngarkimit të dokumentacionit në sistemin informatik tatimor.**

Faleminderit!